

**AKT THEMELIMI**  
**SHOQËRIA TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“SONI Beton Expres” SHPK.**

Sot, në Tiranë, më 10.06.2021 bazuar në legjislacionin shqiptar, me vullnetin tim të lirë, jam shprehur në nënshkrimin si ortak themelues dhe deklaroj se kam përpiluar si më poshtë Aktin e Themelimit të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar “SONI Beton Expres” SHPK.

Unë ortaku i vetëm Mirsim Jella, i biri i Hajdarit i datëlindjës 16.06.1972, lindur në Dibër dhe banues në Tiranë në adresën: Rruga “Gjergj Kastrioti Skenderbeu”, Nd. 22; H. 1; Ap.37, KASHAR, i identifikuar nëpërmjet letërnjoftimin Nr.034281463 dhe me numër personal H20616082S, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar:

**THEMELIMI**

**Neni 1**

Themelohet Shoqëria tregtare “SONI Beton Expres” SHPK, e cila do të nënshtrohet legjislacionit të Republikës së Shqipërisë në fuqi. Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të këtij Akti Themelimi dhe Statutit të Shoqërisë.

**SELIA E SHOQËRISË**

**Neni 2**

Selia e shoqërisë tregtare “SONI Beton Expres” SHPK do të jetë në adresën: Çekrezë, Zall-Herr, Zona Kadastrale 1377, Nr.Pasurisë:482/4

**Neni 3**

Shoqëria tregtare mund ta ushtrojë veprimtarinë e saj në të gjithë juridiksionin territorial të Republikës së Shqipërisë, si dhe jashtë Shtetit.

Shoqëria mund të krijojë seli, filiale, agjensi dhe përfaqësi si në qytete të tjera të Shqipërisë dhe jashtë saj.

Njësitë vartëse të shoqërisë jashtë shtetit do të krijohen nëse kjo e drejtë parashikohet dhe lejohet nga legjislacioni i vendeve të huaja, normat e së drejtës ndërkombëtare dhe parimet e reciprocitetit tregtar mes vendeve të ndryshme.

**OBJEKTI I SHOQËRISË**

**Neni 4**

Shoqëria tregtare krijohet për të ushtruar Aktivitetin e saj Tregtar me objekt: Prodhim betoni, nënprodukteve të tij si dhe të inerteve për tregtim me shumicë e pakicë në ndërtime civile, ushtarake, private, shtetërore, social kulturore etj.

**Neni 5**

Me vendim të organeve vendimarrëse të shoqërisë, Shoqëria mund të zgjerojë aktivitetin e saj tregtar edhe në drejtime të tjera, kur ato janë në interes së mbarëvajtjes së aktivitetit të shoqërisë.

**KAPITALI I SHOQËRISË**

**Neni 6**



Kapitali themeltar i shoqërisë është 8,500,000 Lek (Tetëmiljon e pesëqindmijë lekë), kapital i cili formohet dhe do të jetë në vlerë monetare. Shuma e kapitalit themeltar do të depozitohet në një llogari bankare në emër të shoqërisë në një prej bankave të nivelit të dytë që zhvillojnë aktivitetin në Republikën e Shqipërisë

## KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

### Neni 7

Kohëzgjatja e ushtrimit të veprimtarisë së shoqërisë është pa afat dhe fillon nga data e regjistrimit të saj si person juridik pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakut të Vetëm ka të drejtë të ndryshojë me vendim kohëzgjatjen e ushtrimit të veprimtarisë dhe ky vendim depozitohet menjëherë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit

## DREJTIMI I SHOQËRISË

### Neni 8

Veprimtaria e shoqërisë tregtare "SONI Beton Expres" SHPK do të drejtohet nga Administratori i saj z. Mirsim Jella për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë rizgjedhje.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakut të Vetëm ka të drejtë të emerojë një administrator tjetër, nëse e gykon të nevojshme.

### Neni 9

Administratori i shoqërisë ka të drejtë të punësojë persona të ndryshëm në funksion të zhvillimit të veprimtarisë së shoqërisë

### Neni 10

Shoqëria tregtare "SONI Beton Expres" SHPK do të ketë vulën e saj, në të cilën shkruhet emërtimi i shoqërisë.

### Neni 11

Shoqëria tregtare "SONI Beton Expres" SHPK deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit shqiptar në fuqi.

## THEMELUESI I SHOQËRISË TREGTARE

"SONI Beton Expres" SHPK

ORTAKU I VETËM

